



VENDIM PËR PRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 qershor 2013

Numri i lëndës 2012-14

Valbone Zahiti

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 qershor 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel më 27 shtator 2012.
2. Më 8 prill 2013, Paneli ka vendosur të njoftoj shëfën e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë, duke ftuar atë të dorëzojë vërejtje me shkrim rreth ankesës. Vërejtjet e ShM janë pranuar më 10 maj 2013. Më pas, ato i ishin komunikuar ankueses për komente nga ajo. Ankuesja ka ofruar komentet e saj ndaj vërejtjeve të ShM më 30 maj 2013.

3. Më 20 maj 2013, Paneli ka ftuar ShM që t'i adresoj çështjet e tjera rreth pranueshmërisë që nuk ishin adresuar gjatë parashtrimit të saj të kaluar. Vërejtjet e ShM ishin pranuar më 3 qershor 2013.

II. FAKTET

4. Fakti siç është parashtruar nga palët mund të përmblihet si në vijim.
5. Ankuesja pohon se më 7 qershor 2011 rreth orës 08:25, përderisa ishte duke kryer detyrat e saj zyrtare si police e Kosovës që siguron lokalet e Zyrës Ndërlidhëse të Rumanisë, ishte sulmuar dhe lënduar nga një "zyrtar i EULEX-it", polic ndërkombëtar. Ajo pohon se sulmuesi i saj ishte një pjesëtar i stafit të EULEX-it, i cili qëllimisht voziti në drejtim të saj me makinën e tij, duke e goditur atë me automjetin e tij dhe lënduar këmbën e saj.
6. Ankuesja deklaron se incidenti ka ndodhur si pasojë e përpjekjes nga ana e atij pjesëtari të stafit të EULEX-it për t'u parkuar në mënyrë të paligjshëm. Sipas ankueses, pjesëtari i stafit të EULEX-it u përpoq të parkojë automjetin e tij në një vend ku nuk lejohej të ndalej, pra në një vend të rezervuar për Zyrën Ndërlidhëse të Rumanisë.
7. Është pohuar se pasi që ankuesja kishte paralajmëruar pjesëtarin e stafit të EULEX-it që mos të parkohej në këtë vend, ky i fundit ka filluar ta fyente atë.
8. Më tej, është pohuar se situata ishte përkeqësuar meqenëse pjesëtari i stafit të EULEX-it ka vozitur makinën e tij në drejtim të zyrtares policore të Kosovës, dhe e ka goditur atë në këmbën e saj të djathtë. Ankuesja supozohet se ka urdhëruar zyrtarin e EULEX-it të ndalej, përderisa mbante armën e saj zyrtare dhe kërcënonte se do ta përdorte atë në vetëmbrojtje.
9. Ankuesja deklaron se incidenti i ka shkaktuar "lëndime të menjëhershme", që rezultoi me pasoja afatgjata negative për shëndetin e saj. Ankuesja nuk ishte në gjendje të kthehej në punë për gati tre muaj. Më tej, pohohet se ajo ende vuan nga probleme shëndetësore të vazhdueshme të shkaktuara nga ky incident. Gjithashtu, natyra e punës së saj kërkon gjendje të mirë fizike, mirëpo gjendja e saj e pengon në punën e saj të tanishme profesionale. Ankuesja deklaron se asaj i është dashur të merrte pushim mjekësor dhe pushime të tjera, e që ajo thotë se e kanë rrezikuar punën e saj.
10. Ankuesja ka ofruar dokumentacion mjekësor lidhur me gjendjen e saj të tanishme. Ajo deklaron se Policia e Kosovës nuk ofron ndonjë sigurim shëndetësor, kështu që asaj i është dashur t'i mbulonte të gjitha shpenzimet vetë. Më tej, ankuesja ka paraqitur një raport të përpiluar nga Policia e Kosovës, e që gjithashtu përfshinë një raport të përkohshëm të EULEX-it, të shkruar nga pjesëtari i stafit të EULEX-it në fjalë, që është në kundërshtim me versionin e ankueses. Sipas

versionit të zyrtarit të EULEX-it në këtë raport, ankuesja ishte sjellë në mënyrë agresive ndaj tij. Si pasojë ai u largua me veturë nga vendi i incidentit. Sulmi i dyshuar nuk është përmendur në atë raport.

III. ANKESAT

11. Ankuesja kërkon informacion në lidhje me gjendjen e lëndës së saj brenda EULEX-it dhe pranë gjykatave të shtetit prej nga vjen zyrtari. Ankuesja pohon se për shkak të imunitetit të personelit të misionit, ajo nuk ka qasje në gjykatë kompetente për të vendosur të drejtat e saj në lidhje me dëmin të cilën ajo e ka pësuar. Më tej, ajo kërkon kompensim monetar për dëmin që pretendon se i është bërë shëndetit të saj, si pasojë e këtij incidenti.

12. Ankuesja i pohon shkeljet e mëposhtme të të drejtave të njeriut:

E drejta për një gjykim të drejtë, bazuar në:

- Nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj), dhe
- Nenin 7 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj),

E drejta për mjete efektive juridike, bazuar në:

- Nenin 13 KEDNj, dhe
- Nenin 8 dhe 22 DUDNj,

Ndalimi i diskriminimit, bazuar në:

- Nenin 14 KEDNj,
- Nenin 1 dhe 2 DUDNj,
- Nenin 1, paragrafi 1 dhe 2, nenin 2, paragrafi 1, pika a, b, c, nenin 5, pika a dhe b, dhe nenin 6 të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEFDR),
- Nenin 1, nenin 2, pika b dhe c dhe nenin 3 të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEFDG),

Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave, bazuar në:

- Nenin 17 KEDNj,
- Nenin 28 DUDNj,

Më tej, ankuesja i referohet nenit 2, paragrafi 1, 2 dhe 3, pika a, b, dhe c, nenit 16 dhe nenit 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP). Së fundi, ankuesja i referohet nenit 2, paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 5, paragrafi 1 dhe 2 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK).

IV. LIGJI

LIGJI PËRKATËS NË FUQI

Veprimi i përbashkët

13. Pjesët përkatëse të shkëputura të nenit 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË (më tutje: Veprimi i Përbashkët), thotë si më poshtë:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i në KOSOVË do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndihmë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në KOSOVË do të:

- (a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përdërisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;

Ligji mbi kompetencat

14. Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (nr. 03/L-053, më tutje: Ligji mbi kompetencat) dhe më saktësisht neni i tij 17 i rregullon kompetencat ekzekutive të policisë së EULEX-it:

Neni 17

17.1 Gjatë kohëzgjatjes së EULEX-it KOSOVË në Kosovë, policia e EULEX-it do të ketë kompetencë të ushtrisë kompetencat siç njihen nga ligji i zbatueshëm për Policinë e Kosovës dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara nga shefi i EULEX-it në KOSOVË.

15. Paneli gjithashtu i referohet Shtojcave G dhe J të Planit Operativ të EULEX-it, Procedurave Standarde të Operimit "mbi Hetimin e shkeljeve të pohuara të Kodit të Sjelljes dhe Disiplinës", Kodit të Sjelljes dhe Disiplinës, si dhe Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124 / CFSP i datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (në veçanti, neni 10).

Parashtrimet nga palët

16. Në parashtrimet e tij, EULEX-i pohon se ankesa nuk ka hyrë në kuadër të mandatit të Panelit, meqenëse ngjarjet ndaj të cilave është bërë ankesë nuk ka të bëjnë me veprimet e kryera gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it, dhe se ankesa është regjistruar jashtë afatit

gjashtëmuor. Ata argumentojnë se kjo ankesë duhet të shpallet e papranueshme.

Parashtrimet e EULEX-it lidhur me mandatin ekzekutiv

17. EULEX-i pohon se sipas OPLAN-it, Shtojca J nën B.1 "*PSHDNj-ja do të themelohet për të shqyrtuar ankesa nga çdo person, përveç personelit të EULEX-it, që pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë*". Në B. 6 përsëritet se "*Paneli do ta vlerësoj vetëm sjelljen e EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Prandaj, gjetjet e Panelit nuk kanë për qëllim të formojë bazën për procedura disiplinore apo gjyqësore që përfshijnë pjesëtarët e stafit të EULEX-it në Kosovë*". Më tej, EULEX-it tregon rregullin 25 par. 1 i rregullores së punës së Panelit, ku thuhet se "*[një] ankesa mund të parashtrohet nga çdo person, përveç personelit të EULEX-it të Kosovës, i cili pretendon të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv*".
18. EULEX-i pohon se pjesëtari i stafit të EULEX-it, i cili ka lënduar ankuesen ishte këshilltar në Departamentin e Policisë së Kosovës për Trajnim, dhe për këtë arsye nuk kishte ndonjë kompetencë ekzekutive. Në kohën e incidentit ai nuk kishte qenë duke kryer ndonjë detyrë zyrtare (të EULEX-it). Kështu, ai në atë kohë ka qenë duke vepruar në cilësi private. Për aq sa konsiderohet përkatëse, automjeti kishte qenë privat me targa të BE-së, e nuk ishte automjet zyrtar i EULEX-it.
19. Prandaj, EULEX-i pohon se incidenti i pretenduar nuk ishte në asnjë mënyrë i lidhur me mandatin e Misionit të EULEX-it në Kosovë dhe me detyrat që duhet të kryhen në përmbushjen e atij mandati, siç është përcaktuar në nenet 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët.
20. EULEX-i pohon se veprimet e kryera nga ana e zyrtarit në fjalë nuk mund të barazohen me veprimet *përtej kompetencave* apo në kundërshtim me udhëzimin.
21. Gjithashtu, EULEX-i argumenton se nuk ishte pohuar se pjesëtarët e stafit të EULEX-it (zyrtarë policorë) kishin qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes ose që ka pasur ndonjë përfshirje tjetër e pjesëtarëve të stafit të EULEX-it në atë incident (përveç pjesëtarit të stafit të EULEX-it, i cili e ka lënduar ankuesen).
22. EULEX-i pohon se në lëndën e Al-Jedda kundër Mbretërisë së Bashkuar [Kërkesa nr. 27021/08, 7 korrik 2011] Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm "Gjykata") ka shqyrtuar çështjen e juridiksionit të vet dhe ka konsideruar se "*juridiksioni sipas nenit 1 është një kriter minimal. Ushtrimi i juridiksionit është një kusht i domosdoshëm për një Shtet Kontraktues të jetë në gjendje të mbahet përgjegjës për veprimet apo mosveprimet që i ngarkohet atij, që e ngrit pretendimin e shkeljes së të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë*". Duhet që të testohet në mënyrë që të përcaktohet nëse apo

jo organizata ushtron kontroll efektiv apo autoritet përfundimtar dhe kontroll mbi veprimet dhe mosveprimet e një pale të tretë. Duke pasur parasysh këtë interpretim të ngushtë dhe sipas rrethanave të kësaj çështje, nuk mund të thuhet se EULEX-i kishte pasur "kontroll efektiv" apo "autoriteti përfundimtar dhe kontroll" mbi ndonjë veprimtari të pjesëtarit të stafit të EULEX-it në fjalë dhe për këtë arsye nuk mund të mbahet përgjegjës për veprimet ose mosveprimet që i atribuohen.

Parashtrimet e EULEX-it rreth afatit gjashtë mujor

23. EULEX-i pohon se vetëm ato ankesa që dorëzohen brenda afatit gjashtë mujor nga koha e shkeljes së pretenduar duhej të konsiderohen të pranueshme. Në rastin konkret, incidenti kishte ndodhur më 7 qershor 2011. Ankesa që pretendon shkelje të të drejtave të njeriut marrë parasysh problemet shëndetësore të vazhdueshme që rezultojnë nga ngjarjet e asaj dite është dorëzuar më 27 shtator 2012. Prandaj, ankesa duhet të shpallet e papranueshme marrë parasysh skadimin e periudhës gjashtë-mujore në pajtim me rregullën 25 par. 3 të rregullores së punës së Panelit.

Komentet e ankueses rreth vërejtjeve të ShM

24. Në parashtrimet e saj shtesë të datës 30 maj 2013, në thelb ankuesja ka pohuar se ndarja e brendshme e pushteteve brenda EULEX-it nuk ka rëndësi në marrëdhëniet me palët e treta. Është pohuar se një pjesëtar i stafit të EULEX-it *"i veshur me një uniformë hyn nën juridiksionin e misionit [...] Për një palë të tretë, paraqitja e uniformuar mjafton që veprimet e personit t'i ngarkohen misionit"*. Një palë e tretë nuk kishte obligim që të dijë nëse personi nga personeli i EULEX-it ka ushtruar personalisht kompetenca ekzekutive apo jo. Në këtë drejtim, ankuesja ka parashtruar se në bazë të nenit 17 të Ligjit mbi Juridiksionin *"një zyrtar policor me uniformë që vepron brenda një misioni ka të njëjtat kompetenca ekzekutive si policia e Kosovës"*.
25. Ankuesja më tej pohon se zyrtari i EULEX-it kishte qenë i veshur me një uniformë policie dhe se çdo pjesëtarë i stafit të EULEX-it është përherë nën juridiksionin e misionit.
26. Në lidhje me afatin kohor gjashtë-mujor për të paraqitur ankesë pranë Panelit, ankuesja pohon se, së pari pas aksidentit ajo kishte qenë në pushim mjekësor për një periudhë tre mujore. Së dyti, ajo tregon se besonte që hetuesit e EULEX-it do të kontaktonin atë në lidhje me këtë rast, megjithatë, asnjë nga personeli i EULEX-it nuk e kishin bërë këtë ndonjëherë. Së treti, ankuesja thotë se ajo kishte gjithashtu përshtypjen se rasti ishte shqyrtuar brenda shtetit, i cili e kishte dërguar pjesëtarin e stafit të EULEX-it. Në thelb, ankuesja ka pritur që të informohej për rezultatet e këtyre procedurave. Pasi kjo nuk ndodhi, ankuesja ka kontaktuar me zyrën lokale të Prokurorisë në një datë të pasaktësuar dhe ishte njoftuar se gjykatat vendore nuk kishte kompetencë për të proceduar në rastet kundër EULEX-it. Pas kësaj, ankuesja ka parashtruar rastin e saj tek Paneli. Për shkak të faktit se stafi i EULEX-it

kishte imunitet ndaj prokurorisë vendore, ankuesja pohon se ajo ju është drejtuar Panelit si mjet i fundit.

Parashtrimet e tjera nga shefi i Misionit

27. Më 3 qershor 2013 pas pyetjeve shtesë nga Paneli, ShM ka njoftuar Panelin se Njësia e Hetimit të Brendshëm të EULEX-it (NjHB) kishte nisur një hetim të brendshëm rreth incidentit më 7 qershor 2011. Më 30 qershor 2011, si pasojë e hetimit të brendshëm të tij, EULEX-i ka arritur në përfundim se stafi i EULEX-it kishte shkelur kodin e sjelljes së EULEX-it. Si pasojë, shteti që kishte dërguar këtë pjesëtar të stafit ja kishte përfunduar misionin e tij dhe e kishte kthyer atë në shtetin e tij prej nga vinte. Rasti ishte mbyllur më 13 korrik 2011. Paneli nuk ka marrë informacione se a ishin shqiptuar në të vërtetë masat disiplinore ndaj pjesëtarit të stafit. Më 22 nëntor 2011, Prokuroria Publike Komunale e Prishtinës ishte informuar nga EULEX-i për kthimin e pjesëtarit të stafit në vendin prej nga vinte dhe se Misioni kishte mbyllur hetimin e vet të brendshëm rreth rastit.
28. Më tej, EULEX-i pohon se incidenti përbën shkelje të kodit të sjelljes, mirëpo jo shkelje të të drejtave të njeriut.

Vlerësimi i Panelit

29. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos se a ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në rregullën 29 të rregullores së punës.
30. Më tej i bie Panelit për të përcaktuar karakterizimin ligjor të ankesës. Ai është i mendimit se ankesa duhet të shqyrtohet sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut marrë së bashku me nenin 13 të së njëjtës Konventë.
31. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.

Policia e EULEX-it dhe mandati ekzekutiv

32. Rrethanat e këtij rasti kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljet e një këshilltari të EULEX-it në departamentin e trajnimit policor të Kosovës. Në këtë drejtim, është vërejtur se shefi i Misionit ka pranuar se pjesëtar i stafit të EULEX-it kishte qenë i pranishëm në kohën dhe vendin e incidentit. Më tej, është theksuar se rezultatet e hetimit të brendshëm kanë treguar se ai kishte përplasur makinën e tij në ankuesen duke shkaktuar siç e cilëson EULEX-i "lëndime të lehta trupore".
33. Paneli përdor qasjen e zhvilluar nga ana e Gjykatës, se "[një] shtet mund që gjithashtu të mbahet përgjegjës edhe kur agjentët e saj janë duke vepruar jashtë kompetencave ose në kundërshtim me udhëzimet

(shih *Ilascu dhe të tjerët kundër Rusinë dhe Moldavinë*, nr. i aplikacionit 48787/99, aktgjykimi i datës 8 korrik 2004, në paragrafin 319, faqe 79).

34. EULEX-i ka pohuar se pjesëtari i stafit të tij nuk ishte i ngarkuar me ndonjë fuqi ekzekutive dhe se, në kohën e incidentit, ai nuk ishte duke kryer detyrë zyrtare (të EULEX-it). Prandaj, EULEX-i ka pohuar se incidenti nuk ishte në asnjë mënyrë i lidhur me mandatin e Misionit të EULEX-it në Kosovë.
35. Paneli vënë re pikëpamjen e shprehur nga Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare se ajo është *"një problem i veçantë [...] për të përcaktuar nëse një person i cili është një organ shtetëror vepron në këtë cilësi. Është e parëndësishme në këtë funksion, nëse personi në fjalë mund të ketë pasur motive të fshehta apo të pahijshme apo mund të ketë abuzuar me pushtetin publik. Kur një person i tillë vepron me sa duket në një kapacitet zyrtar, ose nën ngjyrimin e autoritetit, veprimet në fjalë do t'i ngarkohen shtetit"*. Më tej, përgjegjësia e shtetit përjashtohet në qoftë se *"veprimi nuk ka pasur lidhje me funksionin zyrtar dhe në fakt ishte thjesht veprim i një individi privat. Rasti i sjelljes krejtësisht private nuk duhet të ngatërrohet me atë të një organi që funksionon si i tillë përpos nëse vepron jashtë detyrës zyrtare apo shkel rregullat që rregullojnë funksionimin e tij. Në këtë rast të fundit, organi megjithatë është duke vepruar në emër të Shtetit (shih "artikujt e komisioneve të së drejtës ndërkombëtare mbi përgjegjësinë shtetërore: Hyrje, Tekst dhe Komente", James Crawford, Cambridge University Press (2002) në faqen 99).*
36. Për aq sa EULEX-i ka argumentuar se zyrtari në fjalë nuk mund të konsiderohet se është i ngarkuar me kompetenca ekzekutive për shkak se ai kishte qenë duke punuar si një këshilltar i trajnimit, Paneli është i mendimit se është e parëndësishme nëse ai ka punuar për një departament të veçantë në kuadër të EULEX-it ose në një tjetër. Kjo është një çështje e organizimit të brendshëm që nuk mund të ndikojë tek paditësit si palë të treta.
37. Paneli vëren në lidhje me këtë se në pajtim me nenin 17 të Ligjit mbi Kompetencat, *"[për] kohëzgjatjen e EULEX-it Kosovë në Kosovë, policia e EULEX-it do të ketë kompetencë që të ushtrojë kompetencat siç njihen nga ligji në fuqi i Policisë së Kosovës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara nga shefi i EULEX-it në Kosovë"*. Prandaj, policia e EULEX-it si e tillë në parim është e veshur me fuqitë ekzekutive të njëjta si policia e Kosovës, përveç se është e kualifikuar ndryshe sipas modaliteteve të përcaktuara nga ShM. Paneli nuk është në dijeni të ndonjë prej modaliteteve të tilla, të cilat do të kishin efektin e kufizimit të përgjegjësisë së EULEX-it për veprimet e zyrtarëve policorë të tij thjesht për fuqinë e faktit se kanë qenë të ngarkuar me aktivitetet e trajnimit.
38. Prandaj Paneli hedh poshtë parashtrimet e EULEX-it se nuk mund të thuhet që EULEX-i ka pasur "kontroll efektiv" ose "autoritet përfundimtar dhe kontroll" mbi aktivitetet e pjesëtarit të stafit të EULEX-

it në fjalë dhe për këtë arsye nuk mund të mbahen përgjegjës për veprimet apo mosveprimet që atribuohen aty.

39. Më tej, Paneli vëren se EULEX-i nuk e konteston faktin se zyrtari i kontestuar i EULEX-it ka vepruar në mënyrë të papërshtatshme. As nuk është kontestuar se ankuesja kishte pësuar lëndime fizike si pasojë e sjelljes së keqe të tij. Ankuesja më tej pohon se ajo nuk kishte asnjë rrugë ligjore në dispozicion të saj për t'u përpjekur që të marrë një formë të dëmshpërblim për shkeljen e integritetit trupor të saj.
40. Paneli do të shqyrtojë nëse rrethanat e rastit janë të tilla që të mbulohen nga nocioni i mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Paneli thekson se detyra e tij në këtë rast nuk është të merr në shqyrtim nëse sjellja e keqe e zyrtarit mund t'i ngarkohet EULEX-it. Përkundrazi ai është i thirrur për të përcaktuar nëse, në rrethanat e çështjes dhe për qëllime të ushtrimit efektiv të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i ishte i obliguar që të sigurojë rrugët adekuate ligjore me synimin për të ofruar dëmshpërblim të duhur për ankuesen dhe në këtë mënyrë t'i zbatoj detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut sipas neneve 8 dhe 13 të KEDNj-së.
41. Paneli ka pikëpamjen se në bazë të materialit që ka pranë vetes, mënyra me të cilën EULEX-i është marrë me procesin disiplinor në lidhje me njërin prej zyrtarëve policor të tij mund të ngrehë çështjen në lidhje me të drejtën e ankueses për të marrë një kompensim të duhur në pajtim me nenin 13 të KEDNj-së dhe në lidhje me të drejtat e garantuara sipas nenit 8 të Konventës. Paneli, në veçanti, vënë re se informacioni që i është zbuluar deri më tani Panelit nuk ofron tregues të qartë se çfarë hapa, nëse ka ndonjë, janë ndërmarrë nga EULEX-i për të siguruar që veprimet e tij nuk kanë çuar në mohimin e së drejtës së ankueses për të kërkuar dhe për të marrë një zgjidhje të duhur. Prandaj ankesa ngreh çështjet serioze që kanë të bëjnë me nenet 8 dhe 13 të KEDNj-së dhe nuk është haptazi e pabazuar. Është vërtetuar se nuk ka arsye të tjera për ta shpallur atë të papranueshme.
42. Së fundi, Paneli nuk i pranon parashtrimet e EULEX-it që kërkesa është e papranueshme sipas rregullës gjashtë-mujore. Efekti i dëmshëm shkaktuar nga mungesa e një mjeti efektiv juridik është duke vazhduar. Për më tepër, në bazë të materialit pranë Panelit, ankuesja nuk ishte njoftuar zyrtarisht lidhur me vendimin e EULEX-it për largimit të zyrtarit nga puna dhe / ose për kthimit të tij në shtetin prej nga vinte. Në këtë kuptim, asaj ju ishte mohuar mundësia për të kundërshtuar këto vendime në kohën kur ato janë marrë.
43. Paneli konsideron se çështja nëse rasti i ankueses hyn në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it është e lidhur ngushtë me meritat e ankesës. Prandaj ai e bashkon këtë çështje paraprake me meritat e lëndës.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

pa paragjykuar meritat, **E SHPALL TË PRANUESHME** ankesën në lidhje me shkeljet e supozuara të nenit 8 në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese